













































Tabela 2.5: Faktorët e zbatuar të korigjimit dhe parametra të tjerë të llogaritjes

Parametri siç renditet në ICNIRP7	Brezi spektral i vlefshëm (nm)	Vlera
CA	$\lambda < 700$	CA = 1,0
	700 - 1 050	CA = 10 0,002( $\lambda$ - 700)
	1 050 - 1 400	CA = 5,0
CB	400 - 450	CB = 1,0
	450 - 700	CB = 10 0,02( $\lambda$ - 450)
CC	700 - 1 150	CC = 1,0
	1 150 - 1 200	CC = 10 0,018( $\lambda$ - 1150)
	1 200 - 1 400	CC = 8,0
T1	$\lambda < 450$	T1 = 10 s
	450 - 500	T1 = 10 · [10 0,02 ( $\lambda$ - 450) ] s
	$\lambda > 500$	T1 = 100 s
Parametri siç renditet në ICNIRP	E vlefshme për efektin biologjik	Vlera
$\alpha_{min}$	Të gjitha efektet termike	$\alpha_{min} = 1,5$ mrad
Parametri siç renditet në ICNIRP	Gama këndore e vlefshme (mrad)	Vlera
CE	$\alpha < \alpha_{min}$	CE = 1,0
	$\alpha_{min} < \alpha < 100$	CE = $\alpha / \alpha_{min}$
	$\alpha > 100$	CE = $\alpha^2 / (\alpha_{min} \cdot \alpha_{max})$ mrad me $\alpha_{max} = 100$ mrad
T2	$\alpha < 1,5$	T2 = 10 s
	$1,5 < \alpha < 100$	T2 = 10 · [10 ( $\alpha$ - 1,5) / 98,5 ] s
	$\alpha > 100$	T2 = 100 s
Parametri siç renditet në ICNIRP	Intervali i kohës së vlefshme të ekspozimit (s)	Vlera
$\gamma$	$t \leq 100$	$\gamma = 11$ [mrad]
	$100 < t < 104$	$\gamma = 1,1 t 0,5$ [mrad]
	$t > 104$	$\gamma = 110$ [mrad]

Tabela 2.6: Korigjimi për ekspozimin përsëritës

Secili nga rregullat e përgjithshme të mëposhtme duhet të zbatohet për të gjitha ekspozimet përsëritëse, siç ndodhin nga sistemet lazer të pulsuara në mënyrë të përsëritur ose ato të skanimit:

1. Ekspozimi nga çdo puls i vetëm në një varg pulsimesh nuk tejkalon vlerën kufi të ekspozimit për një puls të vetëm të kohëzgjatjes së atij pulsimi.

2. Ekspozimi nga çfarëdo grupi pulsimesh (apo nën grupesh pulsimi në një varg) të lëshuar në një kohë t nuk tejkalon vlerën kufi të ekspozimit për kohën t.

3. Ekspozimi nga çfarëdo grupi pulsimi i vetëm brenda një grupi pulsimesh nuk tejkalon vlerën kufi të ekspozimit të një pulsimi të vetëm të shumëzuar me një faktor korigjimi termik kumulativ  $C_p = N - 0,25$ , ku N është numri i pulsimeve. Ky rregull zbatohet vetëm për kufijtë e ekspozimit për mbrojtjen kundër dëmtimeve termike, ku të gjitha pulsimet e lëshuara në më pak se T<sub>min</sub> trajtohen si një puls i vetëm.

<sup>7</sup> International Commission on Non-ionizing Radiation Protection- Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jo-jonizues



Parametri	Brezi spektral i vlefshëm (nm)	Vlera ose përshkrimi
T <sub>min</sub>	315 <math><\lambda\leq 400</math>	T <sub>min</sub> = 10 <sup>-9</sup> s (= 1 ns)
	400 <math><\lambda\leq 1\ 050</math>	T <sub>min</sub> = 18 · 10 <sup>-6</sup> s (= 18 μs)
	1 050 <math><\lambda\leq 1\ 400</math>	T <sub>min</sub> = 50 · 10 <sup>-6</sup> s (= 50 μs)
	1 400 <math><\lambda\leq 1\ 500</math>	T <sub>min</sub> = 10 <sup>-3</sup> s (= 1 ms)
	1 500 <math><\lambda\leq 1\ 800</math>	T <sub>min</sub> = 10 s
	1 800 <math><\lambda\leq 2\ 600</math>	T <sub>min</sub> = 10 <sup>-3</sup> s (= 1 ms)
	2 600 <math><\lambda\leq 10\ 6</math>	T <sub>min</sub> = 10 <sup>-7</sup> s (= 100 ns)

## SHTOJCA III

## DISPOZITA PËR MBIKËQYRJEN SHËNDETËSORE TË PUNËMARRËSVE TË EKSPOZUAR NDAJ RREZATIMIT OPTIK

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes shëndetësore që synon parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të çdo efekti të dëmshëm, akut dhe kronik, mbi shëndetin si pasojë e ekspozimit ndaj rrezatimit optik, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje dhe legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen shëndetësore, zbatohen dispozitat e përcaktuara në tabelën 3-1.

Tabela 3-1: Objekti dhe shpeshësia e kontrolleve mjekësore për punëmarrësit e ekspozuar ndaj rrezatimit optik

Lloji / brezi i rrezatimit optik	Organi që preket	Ekzaminimet	Shpeshësia e kontrolleve	Komente
Rrezatimi optik artificial				
Ultravjollcë UV	Syri, lëkura	Ekzaminim i përgjithshëm mjekësor, me vëmendje të veçantë ndaj lëkurës, identifikimit të sëmundjeve që shkaktojnë mbindjeshmëri ndaj rrezatimit UV dhe përdorimit të substancave fotosensitive; Ekzaminim oftalmologjik, duke i kushtuar vëmendje kristalinit, konjunktivës dhe kornesë; Në varësi të indikacioneve pas ekzaminimit të	Përpara fillimit të punës me ekspozim ndaj rrezeve UV; Të paktën çdo 3 vjet; çdo 2 vjet për punëmarrësit në moshë më të madhe se 50 vjeç dhe të ekspozuar ndaj rrezatimit UV për më	Ekzaminim mjekësor paraprak për të identifikuar punëmarrësit që kanë kundra-indikacione ndaj ekspozimit ndaj rrezatimit UV, përfshirë punëmarrësit që i përkasin grupeve veçanërisht të ndjeshme të riskut;



Lloji / brezi i rrezatimit optik	Organi që preket	Ekzaminimet	Shpeshtësia e kontrolleve	Komente
		përgjithshëm: ekzaminime dermatologjike.	shumë se 10 vjet; Në çdo rast, kur punëmarrësi konstaton një efekt negativ ose VKE janë tejkaluar.	
E dukshme VIS	Syri	Ekzaminim i përgjithshëm mjekësor, me vëmendje të veçantë ndaj lëkurës dhe identifikimit të sëmundjeve që shkaktojnë mbindjeshmëri ndaj rrezatimit VIS dhe përdorimit të substancave fotosensitivë; Ekzaminim oftalmologjik, duke i kushtuar vëmendje retinës.	Përpara fillimit të punës me ekspozim ndaj rrezeve të dukshme VIS; Të paktën çdo 3 vjet; Në çdo rast, kur punëmarrësi konstaton një efekt negativ ose kur tejkalohen VKE.	Ekzaminime paraprake për të identifikuar punëmarrësit që kanë kundërrindikacione mjekësore për t'u ekspozuar ndaj rrezatimit VIS, përfshirë punëmarrësit që i takojnë grupeve veçanërisht të ndjeshme të riskut.
Infra të kuqe IK	Syri, lëkura	Ekzaminim i përgjithshëm, me vëmendje të veçantë ndaj lëkurës; Ekzaminim oftalmologjik, duke i kushtuar vëmendje kristalinit, konjunktivës, kornesë dhe retinës.	Përpara fillimit të punës me ekspozim ndaj rrezatimit IK; Të paktën çdo 3 vjet. Në çdo rast, kur punëmarrësi konstaton një efekt negativ ose kur tejkalohen VKE.	Ekzaminime paraprake për të identifikuar punëmarrësit që kanë kundërrindikacione mjekësore për t'u ekspozuar ndaj rrezatimit IK, përfshirë punëmarrësit që i përkasin grupeve veçanërisht të ndjeshme të riskut.
Lazer (të gjitha gjatësitë e valës)	Syri, lëkura	Ekzaminim i përgjithshëm, me vëmendje të veçantë ndaj lëkurës; Ekzaminim oftalmologjik, duke i kushtuar vëmendje kristalinit, kornesë dhe retinës.	Përpara fillimit të punës me ekspozim ndaj rrezeve lazer; Të paktën çdo	Ekzaminime paraprake për të identifikuar punëmarrësit që kanë kundërrindikacione



Lloji / brezi rrezatimit optik	Organi që preket	Ekzaminimet	Shpeshtësia e kontrolleve	Komente
			3 vjet; Në çdo rast, kur punëmarrësi konstaton një efekt negativ ose kur tejkalojnë VKE.	mjekësore për t'u ekspozuar ndaj rrezatimit lazer, përfshirë punëmarrësit që i përkasin grupeve veçanërisht të ndjeshme të riskut.
Rrezatimi optik natyror (drita e diellit)				
UV+VIS +IK	Syri , lëkura	Ekzaminim i përgjithshëm mjekësor, me vëmendje të veçantë ndaj lëkurës, identifikimit të sëmundjeve që shkaktojnë mbindjeshmëri ndaj rrezatimit optik natyror, dhe përdorimit të substancave fotosensitivë; Ekzaminim oftamologjik, me vëmendje ndaj kristalinit, konjunktivës, kornesë dhe retinës; Në varësi të indikacioneve dhe pas ekzaminimeve të përgjithshme: ekzaminim dermatologjik	Përpara fillimit të punës me ekspozim ndaj rrezatimit optik natyror; Të paktën çdo 3 vjet; çdo 2 vjet për punëmarrësit në moshë më të madhe se 50 vjeç dhe të ekspozuar ndaj rrezatimit optik natyror për më shumë se 10 vjet; Në çdo rast, kur punëmarrësi konstaton një efekt negativ në shëndet	Ekzaminime paraprake për të identifikuar punëmarrësit që kanë kundërsindikacione mjekësore për të qenë të ekspozuar ndaj rrezatimit optik natyror, përfshirë punëmarrësit që i përkasin grupeve veçanërisht të ndjeshme të riskut



Dixhitalizuar nga Qendra per Çeshtjet e Informimit Publik , INFOÇIP  
www.infocip.org  
www.vendime.al  
mbeshtetur nga Olof Palme Center